VENDIM
Nr. 160, datë 20.10.2020

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "ENERGIJA DOO VETERNIK" NR. 316, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 140, DATË 21.11.2015

Në mbështetje të neneve 16; të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 10, pikat 1, 2 dhe 3, dhe nenit 16, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 109/4 prot., datë 13.10.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë "Energija DOO Veternik" sh.p.k. për rinovim licence në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Energija DOO Veternik" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1086 prot., datë 6.10.2020, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në datën 6.01.2015 është regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).
- Shoqëria "Energija DOO Veternik" sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 316, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 140, datë 21.11.2015.
- Licenca dhënë shoqërisë "Energija DOO Veternik" sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike ka afat deri më 21.11.2020, ndaj afati i fundit për aplikim nga shoqëria "Energija DOO Veternik" sh.p.k., për rinovimin e kësaj licence ishte data 21.9.2020.
- Shoqëria "Energija DOO Veternik" nuk ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës, pasi aplikimi i saj është paraqitur në ERE në datën 6.10.2020.
- Shoqëria "Energija DOO Veternik" sh.p.k. ka depozituar një dokumentacion të konsiderueshëm, bashkëlidhur aplikimit të saj për rinovim të licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, por ky aplikim nuk është paraqitur në afat sipas kërkesave të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".
- Sipas nenit 10, pika 7, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri, në përputhje me pikën 6 të këtij neni, brenda 1 muaji nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "Energija DOO Veternik" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nr. 316, seria T15, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 140, datë 21.11.2015.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti